

Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

**Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë/Mitrovica:
Risitë lidhur me status dhe shqetësimet e vazhdueshme për të drejta të njeriut**

Edicioni 1

Shkurt 2010

Hyrje

Që nga shkurti 2008, sistemi gjyqësor në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica ka funksionuar vetëm në kapacitet të kufizuar. Kështu, rajoni tashmë për afër dy vjet mbeti pa sistem gjyqësor plotësisht funksional.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë (OSBE) ka publikuar disa raporte ku ka nënvizuar shkeljet e të drejtave të njeriut që kanë rezultuar nga funksionimi i kufizuar i gjykatave në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica.¹ OSBE vazhdimisht ka theksuar ndikimin negativ të cilin gjyqësori jo-plotësisht funksional në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica ka mbi sundimin e ligjit në përgjithësi, dhe në veçanti mbi ushtrimin e të drejtave themelore siç janë e drejta për liri,² e drejta për qasje në drejtësi dhe e drejta për gjykim korrekt brenda kohës së arsyeshme.²

Që nga koha e raportimit të fundit, nuk ka pasur ndonjë përparim të madh në operimin e institucioneve për sundim të ligjit në këtë rajon. Ky raport prezanton risitë në statusin aktual mbi funksionimin e gjyqësisë në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica dhe ri-përsërit shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut si dhe kushtet e vështirësuara të punës në disa zyra gjyqësore.³

Risitë lidhur me status

Kompleksi i gjykatës në Mitrovica/Mitrovicë ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicë/Mitrovica – në të cilin para shkurtit 2008 ishin të vendosura gjykata e qarkut e Mitrovicë/Mitrovica, gjykata komunale, gjykata për kundërvajtje dhe prokuroria e qarkut – ka mbetur e pa-qasshme për gjyqtarët dhe prokurorët publik lokal dhe personelin ndihmës të tyre që pas ngjarjeve të muajve shkurt-mars 2008.⁴ Në këtë kompleks të gjykatës aktualisht është i vendosur personeli i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) – që do të thotë gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it së bashku me personelin e tyre ndihmës vendor (shqiptarë të Kosovës dhe serb

¹ Shih raportin mujor të Seksionit për Monitorimin e Sistemit Juridik të OSBE-së– mars 2008, Reagimet ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës ndikojnë seriozisht në sistemin e drejtësisë në Mitrovicë/Mitrovica dhe ndikojnë negativisht në gjykatat e regjioneve tjera, duke rezultuar me shkelje të të drejtave të njeriut. Shih gjithashtu raportin mujor të Seksionit për Monitorimin e Sistemit Juridik të OSBE-së – dhjetor 2008, Shqetësimet e vazhdueshme për të drejtat e njeriut dhe zhvillimet e fundit. Shih po ashtu edhe raportin mujor të Seksionit për Monitorimin e Sistemit Juridik të OSBE-së– Përdorim i Paraburgimit në Procedurat Penale në Kosovë: Shqyrtim dhe Analizë Gjithëpërfshirëse e Brengave të Mbetura (Pjesa I), faqe 22-23.

² Nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (që këtej, “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”).

³ Informacioni i përfshirë në këtë raport është marr nga OSBE përmes monitorimit të drejtpërdrejtë si dhe përmes intervistave me zyrtarë gjyqësor të kryera gjatë nëntorit 2009.

⁴ Duke filluar nga 21 shkurti 2008, një grup prej 50 deri në 200 protestues, në mes tyre edhe të punësuarit e sistemit gjyqësor të para-1999-ës, u mbledhën jashtë kompleksit të gjykatës në Mitrovicë/Mitrovica (gyjkata e qarkut, gjykata komunale, gjykata për kundërvajtje dhe prokuroria e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica) në mëngjeset e ditëve të punës duke kërkuar që të hyjnë në ndërtesë dhe që ajo të i kthehet sistemit gjyqësor të Serbisë. Protestuesit hynë me forcë në ndërtesë me 14 mars 2008. Me 17 mars 2008 në një operacion të përkrahur nga KFOR-i, Policia e UNMIK-ut hyri në ndërtesë dhe arrestoi uzurpuesit. Trazira serioze civile pasuan të cilat quan në vdekjen e një polici civil ndërkombëtar.

të Kosovës) si dhe atë ndërkombëtar– të cilët ishin vendosur aty zyrtarisht me 9 dhjetor 2008. Personeli i EULEX-it që është i caktuar për këtë gjykatë aktualisht përbëhet nga dy gjyqtarë penal, dy prokurorë, dy gjyqtarë civil dhe tre zyrtarë ligjor. Deri më sot, personeli i EULEX-it i vendosur në këtë gjykatë ka përfunduar katër lëndë penale.⁵

Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vendor të cilët më parë punonin në kompleksin e gjykatës në veri të Mitrovicë/Mitrovica vazhdojnë punën me kapacitet të kufizuar në gjykatën e qarkut të rivendosur në hapësirat e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn. Kjo gjykatë e rivendosur e qarkut aktualisht mban seanca dëgjimore në lëndët me paraburgim, lëshon vendime në lëndët e shkurorëzimeve, dhe procedon kërkesat për njohjen e aktvendimeve të huaja.⁶ Gjykata e qarkut po ashtu mbulon komunat e Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn, duke i shtuar këto komuna në listën e komunave pa sistem gjyqësor plotësisht funksional.

Niveli i gjykatës komunale

Gjykata komunale e Mitrovicë/Mitrovica (e cila mbulon Mitrovicë/Mitrovica e veriut dhe të jugut si dhe Zvečan/Zveçan) gjithashtu operon në kapacitet të kufizuar nga hapësirat e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn. Në rastet penale, kjo gjykatë trajton të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me paraburgim dhe mban seanca për konfirmim të aktakuzave në lëndët ku përfshihen të pandehurit që mbahen në paraburgim; ka mbajtur gjithashtu disa seanca gjyqësore. Në rastet civile, gjykata mban gjykime vetëm në të ashtuquajturat raste emergjente ku përfshihen rastet e pengim-posedimit, rastet e dhunës në familje, rastet lidhur me plotësimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë mbi kujdesin e fëmijës, dhe rastet e trashëgimisë. Nga shkurti 2008 gjykata komunale e Mitrovicë/Mitrovica ka mbajtur dhe përfunduar gjykimet në përafërsisht 17 raste penale (një nga këto raste është kryer nga gjyqtarët e EULEX-it) dhe ka trajtuar 18 lëndë civile (përfshirë këtu edhe pesë lëndë që bien nën juridiksionin gjykatës së Vushtrri/Vučitrn e si të tilla u janë përcjellë kësaj gjykate). Gjykata ofron shërbime minimale për legalizime: zyra e saj e legalizimeve, e hapur tri ditë në javë, legalizon kontrata dhe ndryshime të kontratave, lëshon autorizime si dhe certifikata mbi hetime penale.

⁵ Gjyqtarët e EULEX-it që janë të vendosur në gjykatën komunale dhe të qarkut të Mitrovicë/Mitrovica në gjykatën në veri të Mitrovicë/Mitrovica., në mars 2009 kanë përfunduar një gjykim të një rasti të plaçkitjes në objektin. Gjykimi i dytë ishte përfunduar nga mesi i majit ku përfshihej një i pandehur shqiptar i Kosovës dhe një viktimë serb të Kosovës, mbi akuza të shkakimit të lëndimit të lehtë trupor dhe dëmtim të pronës së luajtshme, u përfundua në mes të majit. Gjykimi i tretë ku përfshiheshin akuza të veprave të pandehura të terrorizmit (të cilat prokuroria i tërhoqi në një fazë të mëvonshme) dhe nxitjes së urrejtjes etnike, nacionale, fetare, përçarjes edhe jo-tolerancës përfundoi me 19 nëntor 2009. Gjykimi i katërt, mbi akuza të vrasjes në tentativë dhe posedimit, kontrollimit ose përdorimit të paautorizuar të armëve, kishte përfunduar me 7 dhjetor 2009. Një gjykim i pestë ku përfshiheshin akuza të lëndimit të lehtë trupor përfundoi me 19 janar 2010. Gjyqtarët e EULEX-it kanë caktuar edhe tre gjykime që të fillojnë në janar dhe shkurt 2010.

⁶ Në vitin 2008 gjykata e qarkut e Mitrovicë/Mitrovica ka njohur 352 aktgjykime të huaja, dhe në 11 muajt e parë të 2009 ka njohur 355 aktgjykime të huaja.

Niveli i gjykatës komunale për kundërvajtje

Gjykata për kundërvajtje e Mitrovicë/Mitrovica gjithashtu funksionon me kapacitet të kufizuar nga hapësirat e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn. Nga fundi i shkurtit 2008, kjo gjykatë ka pranuar 8.400 lëndë me origjinë nga pjesa jugore e komunës së Mitrovicë/Mitrovica (gjykata nuk ka pranuar ndonjë lëndë nga pjesa veriore). Në gjysmën e dytë të 2009-ës, stacionet policore nga veriu i Mitrovicë/Mitrovica dhe Zvečan/Zveçan filluan të dorëzojnë raste të pengimit të rregullit dhe qetësisë publike në gjykatën për kundërvajtje të Mitrovicë/Mitrovica. Në periudhën janar-nëntor 2009 kjo gjykatë ka pranuar më shumë se 9.700 lëndë, përfshirë këtu edhe ato nga Mitrovicë/Mitrovica veriore dhe Zvečan/Zveçan. Për shkak të kushteve aktuale të vështira për punë, gjykata pranon dhe regjistron të gjitha lëndët që arrijnë. Megjithatë, ajo trajton vetëm ato që shqyrtohen me procedurë të shkurtë si dhe rastet urgjente, siç janë rastet që përfshijnë prishjen e rendit dhe qetësisë publike, aksidentet e komunikacionit, konfiskimin e dokumenteve nga policia dhe rastet të cilat duhet të transferohen në gjykatat tjera në Kosovë.

Gjykatat komunale dhe për kundërvajtje të Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq mbeten jo-funksionale që prej shkurtit 2008. Asnjë lëndë civile ose kundërvajtje që bie mbi juridiksionin territorial të këtyre gjykatave nuk është duke u proceduar. Prej të gjitha rasteve penale janë duke u trajtuar vetëm ato në të cilat parashihet paraburgimi, përmes transferimit të juridiksionit në ndonjë gjykatë tjetër komunale në rajon. Kjo praktikë e transferimit të juridiksionit ka nisur në fillim të 2009-ës dhe kryhet përmes kërkesave që i adresohen kryetarit të gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica i cili zakonisht i aprovon kërkesat e tilla. Kryetari i gjykatës komunale në Zubin Potok është ofruar që të vij në gjykatën komunale në Vushtrri/Vučitrn dhe të trajtoj rastet ku përfshihet paraburgimin të cilat bien nën kompetencën territoriale të gjykatës komunale në Zubin Potok.

Gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje në Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn në këtë pikë janë gjykatat e vetme në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica që operojnë pak a shumë normalisht, ndonëse gjykata komunale në Vushtrri/Vučitrn i ka hapësirat të mbingarkuara për shkak të faktit se në të janë të rivendosura gjykata e qarkut, komunale dhe ajo për kundërvajtje e Mitrovicë/Mitrovica si dhe prokuroria publike e qarkut dhe komunale e Mitrovicë/Mitrovica me gjithë personelin e tyre. Po ashtu vlen të ceket, siç është përmendur edhe më herët, ankesat e parashtruara kundër aktgjykimeve të lëshuara nga gjykatat komunale të Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn nuk mund të procedohen për shkak të mos-funksionimit të gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, që ka juridiksion mbi ankesa të tilla.

Niveli i prokurorisë së qarkut dhe asaj për kundërvajtje

Sa i përket shërbimit të prokurorisë, prokuroria publike e qarkut dhe ajo komunale e Mitrovicë/Mitrovica – që mbulojnë të gjitha gjashtë komunitat e rajonit: Leposavić/Leposaviq, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Zubin Potok, dhe Zvečan/Zveçan) janë gjithashtu duke operuar aktualisht nga hapësirat e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn, prej nga ata ushtrojnë detyra të kufizuara prokuroriale.

Prokuroria publike e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica kryen të gjitha detyrat deri në, dhe përfshirë edhe ngritjen e aktakuzës. Megjithatë, nuk ka konfirmime të aktakuzave nga gjykata. Kështu, procedurat penale që bien nën juridiksionin e gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica ndalohen në fazën e konfirmimit të aktakuzës.⁷

Prokuroria publike komunale në Mitrovicë/Mitrovica kryen të gjitha detyrat deri në dhe përfshirë edhe ngritjen e aktakuzës, merr pjesë në seancat për konfirmim të aktakuzave në rastet që bien nën kompetencën e gjykatës komunale në Mitrovicë/Mitrovica; dhe që ndodhin në jug të Mitrovicë/Mitrovica ku përfshihen të pandehur që gjinden në paraburgim. Prokurorët publik komunal kryejnë detyra të ngjashme sa i përket rasteve që vijnë nga Mitrovicë/Mitrovica e veriut dhe Zvečan/Zveçan të cilat parashohin paraburgimin ose konsiderohen raste me prioritet që nga natyra e tyre kërkojnë veprim të shpejtë. Prokurorët gjithashtu marrin pjesë në disa seanca gjyqësore. Prokurorët tani janë duke trajtuar raste që bien nën kompetencën e gjykatave komunale në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok, ku ata kryejnë të gjitha detyrat e sipërpërmendura (kurdo që është e nevojshme, një kërkesë i parashtrohet kryetarit të gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica për të transferuar kompetencën në ndonjë gjykatë tjetër që ka juridiksion të njëjtë lëndor nga rajoni i Mitrovicë/Mitrovica). Prokurorët komunal vazhdojnë të kryejnë një spektër të tërë të detyrave prokuroriale në rastet që bien nën kompetencën e gjykatave komunale në Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica.

Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it

Vendosja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në dhjetor 2008, ka sjell disa përmirësime në funksionimin e gjyqësorit në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica deri më tani, pasi që kapacitet akoma të kufizuara të EULEX-it lejojnë që rastet më serioze nga Mitrovicë/Mitrovica të ndiqen dhe gjykohen në mënyrë efektive. Siç është cekur më lartë, deri me sot, gjyqtarët e EULEX-it që janë të vendosur në gjykatën e qarkut dhe atë komunale në Mitrovicë/Mitrovica kanë përfunduar pesë raste penale. Në gusht 2009 EULEX-i gjithashtu ka filluar të mbajë seanca të veçanta për të marr përsipër rastet nga gjyqësori vendor. Vlen të përmendet se në seanca të tilla, në të cilat marrin pjesë kryetari i gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica së bashku me gjyqtarë dhe prokurorë tjerë vendor, mbahen në hapësirat e kompleksit të gjykatës në veri të Mitrovica/Mitrovicë. Siguria në seanca të tilla mbahet nga EULEX-i dhe deri me tani ato janë mbajtur pa ndonjë incident.

EULEX-i po ashtu ka marr hapa për të përgatitur procedimin e të gjitha rasteve tjera që janë në pritje. Me atë qëllim, në fund të korrikut 2009 EULEX-i, me ndihmë të stafit vendor nga gjykata e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica filloi evidentimin e shkresave të lëndëve civile dhe penale që ndodheshin në objektin e gjykatës në veri të Mitrovicë/Mitrovica që bien nën juridiksionin e gjykatës së qarkut të Mitrovicë/Mitrovica.⁸ Ekipi i evidentimit përfundoi procedimin e shkresave të lëndëve

⁷ Rastet e vetme që bien nën juridiksionin e gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica në të cilat janë konfirmuar aktakuzat dhe mbajtur gjykimet janë ato që trajtohen nga stafi i EULEX-it– shih më lartë.

⁸ Ekipi i evidentimit i përbërë nga katër (dy serb të Kosovës dhe dy shqiptarë të Kosovës) punonjës administrativ të gjykatës së qarkut dhe komunale në Mitrovicë/Mitrovica, kishte për detyrë të gjej,

penale në mes të tetorit 2009 dhe evidentimin e shkresave të lëndëve civile në nëntor 2009.⁹ Numri i përgjithshëm i shkresave të lëndëve civile dhe penale që janë gjetur dhe organizuar nga ekipi i evidentimit sillet përafërsisht rreth 3.500.¹⁰

Prej të gjitha shkresave të lëndëve penale të evidentuara dhe të arkivuara në objektin e gjykatës në veri të Mitrovicë/Mitrovica, 42 raste ishin identifikuar nga EULEX-i si raste me prioritet. Shumica nga këto 42 raste përfshijnë të pandehur që janë duke u mbajtur në paraburgim. Këtyre rasteve (të cilat ndodhen në faza të ndryshme procedurale, prej hetimeve deri në gjykim [të pezulluar]) duhet t'u jepet prioritet mbi të gjitha rastet tjera dhe do të jenë të parat që do të trajtohen nga gjyqtarët e EULEX-it në rajon. Në një fazë të mëvonshme parashihet se rastet do të trajtohen nga grupe të gjyqtarëve dhe prokurorëve etnikisht të përziera, të përbëra nga pesë gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë të Kosovës, pesë gjyqtarë dhe prokurorë serb të Kosovës dhe pesë gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it. Ende nuk dihet data se kur ky grup i përzierë i gjyqtarëve dhe prokurorëve do të fillojë punën.

Shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut

Si rezultat, mungesa e sistemit gjyqësor plotësisht funksional në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica çon në shkelje serioze të të drejtave të njeriut, në veçanti në shkelje të:

- drejtës për qasje në drejtësi;
- drejtës për gjykim korrekt, dhe;
- të drejtës për liri.

E drejta për qasje në gjykatë

Praktika e themeluar gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) parasheh se “Çdokush [ka] të drejtën që ta ketë çfarëdo parashtrese që ndërlihet me të drejtat dhe obligimet e tij civile të dorëzuar pranë gjykatës ose tribunalit,”¹¹ dhe se “pengesa, qoftë edhe e karakterit të përkohshëm, mund të bie në kundërshtim me Konventën [Evropiane] [për të Drejtat e Njeriut].”¹² GjEDNj ka përcaktuar të drejtën për qasje në gjykatë si veti elementare të konceptit më të përgjithshëm mbi “sundimin e ligjit”, që është pjesë e “trashëgimisë së përbashkët” të shteteve të Këshillit të Evropës.¹³

organizojë, regjistrojë dhe klasifikojë shkresat e lëndëve që ndodheshin në objektin e gjykatës në veri të Mitrovica/Mitrovicë të cilat bien nën juridiksion të gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica.

⁹ Me 6 tetor 2009, ekipi i evidentimit ishte përforcuar me dy punonjës shtesë administrativ (një shqiptar i Kosovës, administrator i prokurorisë publike të qarkut në Mitrovicë/Mitrovica dhe një serb të Kosovës, sekretar ekzekutiv nga gjykata komunale në Mitrovicë/Mitrovica) dhe ka filluar evidentimin e shkresave të lëndëve në prokurorinë publike të qarkut.

¹⁰ Në komunikatën e vet për shtyp të 14 tetorit 2009, EULEX-i jap një numër të përafërt të më shumë se 3.000 shkresave të lëndëve që janë gjetur, organizuar, regjistruar dhe klasifikuar.

¹¹ GjEDNj, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi 4451/70, 21 shkurt 1975, paragrafi 36.

¹² *Ibidem*, paragrafi 26.

¹³ *Ibidem*, paragrafi 34.

Në çështjet civile në veçanti, “njeriu vështirë që mund të përfitoj nga sundimi i ligjit pa ju dhënë mundësia e të pasurit qasje në gjykatë”¹⁴

Banorëve të Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq u është penguar vazhdimisht e drejta për qasje në drejtësi që nga 20 shkurti 2008 deri më sot. Vetëm në disa raste që janë konsideruar “prioritet” ose urgjente individët kanë mundur të kërkojnë dhe të marrin drejtësi pranë gjykatave të rivendosura që funksionojnë në kapacitete të kufizuara, siç është përshkruar më lartë. E njëjta qëndron për individët rastet e të cilëve bien nën juridiksionin e gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica. EULEX-i ka trajtuar vetëm një fraksion të vogël të lëndëve penale pranë kësaj gjykate, përderisa shumica dërmuese e procedurave si në gjykimet penale ashtu edhe në paditë civile vazhdojnë të mbeten të suspenduara për kohë të pacaktuar.

Mungesa e gjykatës së qarkut plotësisht funksionale gjithashtu e pengon edhe procedimin e ankesave të parashtruara kundër vendimeve të gjykatave komunale në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica. Në disa raste të cilat kanë përfunduar pak para shkurtit 2008, ankesat nuk kanë mundur të parashtrohen për shkak se gjykata kishte shpallur vendimin vetëm gojarisht, dhe nuk arriti të nxjerrë aktgjykime me shkrim për shkak të mos-qasjes në shkresat e lëndëve të cilat mbetën në veri.

Në tri raste penale, në të cilat aktgjykimet e shkallës së parë ishin shpallur gojarisht para se të ketë ndaluar funksionimin kompleks i gjykatës, gjyqtarët nuk kanë mundur të lëshojnë aktgjykimet me shkrim pasi që shkresat e lëndëve kishin mbetur në objektin e gjykatës në veri. Andaj, si prokurorët publik ashtu dhe të pandehurit ishin privuar nga e drejta e tyre për të parashtruar ankesa në ato raste. Me ndihmën e EULEX-it, këto tri shkresa të lëndëve ishin nxjerrë nga gjykata në veri të Mitrovicë/Mitrovica, dhe pastaj gjyqtarët e gjykatës së qarkut kishin përpiluar aktgjykimet me shkrim në të tria rastet, kështu që ankesa në këto raste u bë e mundshme. Dy raste janë tashmë me ankesë pranë Gjykatës Supreme. Ankesa për rastin e tretë është ende në pritje.

Një tjetër problem serioz lidhur me mungesën e një sistemi plotësisht funksional gjyqësor në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica, ka të bëjë me skadimin e mundshëm të parashkrimit ligjor për shumë raste penale dhe kundërvajtje që kanë ndodhur në Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq.¹⁵

Siç u përmend më herët në këtë raport, shumica dërmuese e veprave penale dhe kundërvajtjeve që nuk janë urgjente, të cilat ndodhin në këto komuna, nuk mund të

¹⁴ *Ibidem*, paragrafi 34.

¹⁵ Ky kërcënim lidhur me skadimin e mundshëm të periudhës së parashkrimit ligjor para se rastet të trajtohen në mënyrë efektive qëndron edhe për rastet shkresat e lëndëve të të cilave janë të bllokuara në objektin e gjykatës në veri të Mitrovicë/Mitrovica, në mënyrë të veçantë rastet që përfshijnë kundërvajtje dhe vepra penale që bien nën juridiksionin e gjykatës komunale, për të cilat ligji parasheh periudhë të shkurtër të parashkrimit ligjor. Shih nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit për Kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 23/79) dhe nenin 90 paragrafi 1 pika 6 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet e mëvonshme (KPPK).

ndiqen penalisht dhe/ose të përfundojnë në mënyrë efektive, gjë që nga ana e vet sjell rrezikun e skadimit të periudhës së parashkrimit ligjor në disa raste, para se ato të trajtohen siç duhet.¹⁶ Ky rrezik është veçanërisht i lartë për kundërvajtjet, për të cilat ligji parasheh një periudhë mjaft të shkurtër të parashkrimit ligjor.¹⁷ Pamundësia për t'i zgjidhur siç duhet këto vepra penale dhe kundërvajtje prodhon si efekt mohimin e të drejtës së viktimës për të kërkuar drejtësi. Ky mohimi aq i gjerë ka një ndikim serioz mbi sundimin e ligjit në rajon dhe dëmton rëndë besimin e publikut në zbatimin e ligjit dhe të drejtësisë në përgjithësi.

E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme

GjEDNj ka gjetur se e drejta e një individi për gjykim brenda kohës së arsyeshme gjeneron një detyrim reciprokisht pozitiv mbi autoritetet që të organizojnë sistemin e tyre ligjor në një mënyrë të tillë që të ua mundësojë gjykatave për të përmbushur kushtin e "kohës të arsyeshme".¹⁸ Trazira publike në rajonin ku mbahet një gjykim mund të justifikojë vonesat në procedurë vetëm për aq kohë sa autoritetet publike të ndërmarrin hapa për transferimin e rasteve të një tjetër juridiksion.¹⁹ Në përgjithësi, sa herë që autoritetet publike ballafaqohen me grumbullim të përkohshme të punës, ata duhet të ndërmarrin me shpejtësinë e duhur, veprime korrigjuese për të trajtuar një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji.²⁰

Të ballafaquar me ndërprerje në funksionimin e gjykatave në Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq, autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë vetëm masa të kufizuara për të trajtuar situatën. Aktualisht të rivendosura, gjykata e qarkut, komunale dhe ajo për kundërvajtje e Mitrovicë/Mitrovica trajtojnë vetëm rastet penale, civile dhe kundërvajtjet urgjente, ose me prioritet. Shumë prej atyre rasteve nuk janë përfunduar, por janë lënë pezull në ndonjë fazë procedurale, siç është përshtuar më lartë. Vetëm rastet urgjente penale nga gjykatat komunale jo-funksionale në Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq kanë filluar të transferohen në gjykatat me juridiksion të nivelit të njëjtë vetëm pas afërsisht një viti nga momenti kur këto gjykata ndaluan funksionimin. Procedimi i rasteve të tilla urgjente penale, civile dhe të kundërvajtjeve qoftë në gjykatat e rivendosura apo përmes transferimit të juridiksionit, është një zhvillim pozitiv në

¹⁶ Bazuar në nenin 91 (2) KPPK mos-funksionimi i plotë i gjykatave dhe shërbimeve të prokurorisë në komunat veriore mund megjithatë të justifikojë ndërprerjen e periudhës së parashkrimit ligjor për ndjekje penale. Një sqarim lidhur me këtë pikë nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës do të ishte shumë e dobishme.

¹⁷ Shih nenin 27 paragrafi 1 nga Ligji mbi Kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nr. 23/79).

¹⁸ Shih, për shembull, GjEDNj, *Spentzouris kundër Greqisë*, 47891/99, Aktgjykim, 7 maj 2002, paragrafi 27. Shih gjithashtu *Eckle kundër Gjermanisë*, 8130/78, Aktgjykim, 15 korrik 1982, paragrafi 92. Në një tjetër rast Gjykata vlerësoi se "një zbrapsje e përkohshme e punës nuk ka të bëjë me detyrimin e [...] [Institucioneve], me kusht që ata të ndërmarrin, me shpejtësinë e duhur, veprimet korrigjuese për të trajtuar një situatë të jashtëzakonshme" (GjEDNj, *Milasi kundër Italisë*, 10527/83, Aktgjykim, 25 qershor 1987, paragrafi 18).

¹⁹ Shih, GjEDNj, *Foti kundër Italisë*, 7604/76, 7719/76, 7781/77 dhe 7913/77, Aktgjykim, 10 dhjetor 1982, paragrafi 61.

²⁰ Shih GjEDNj, *Baggetta kundër Italisë*, 10256/83, Aktgjykim, 25 qershor 1987, paragrafi 23.

vetvete, por kjo nuk mund të mbulojë faktin se shumica e rasteve pranë gjykatave të Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq ende janë të vonuara ose të pezulluara për kohë të pacaktuar. EULEX-i, me mandatin e vet²¹ dhe nivelin e tanishëm të personelit, ndihmon në ndjekjen penale dhe gjykimin e disa prej rasteve më të rënda, por kjo nuk mund të kompensojë mungesën e një gjyqësori plotësisht funksional në rajon.

Kjo do të thotë se vonesat e paarsyeshme në procedimin e rasteve pranë gjykatave në Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq ka gjasa të vazhdojnë të jenë normë e jo përjashtim. Veçanërisht shqetësuese është gjendja në gjykatën e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, e cila nga natyra e juridiksionit të vet duhet të trajtojë rastet ku përfshihen veprat më të rënda penale. Gjatë vitit 2009, ka pasur 120 aktakuza në pritje të konfirmimit para kësaj gjykate, dhe nuk është ende e qartë se kur do të konfirmohen këto aktakuza dhe rastet të referohen për shqyrtim kryesor.

Me 26 maj 2008 një prokuror i qarkut i Mitrovicë/Mitrovica kishte ngritur një aktakuzë kundër një oficeri të policisë, shqiptar i Kosovës duke e akuzuar atë për vrasje të rëndë në tentativë;²² pronësi, kontroll, posedim, apo përdorimin të paautorizuar të armëve;²³ marrje ryshfeti;²⁴ shpërdorimi të pozitës ose autoritetit zyrtar;²⁵ mashtrim;²⁶ dhe dy akuza të keqtrajtimit në ushtrimin e detyrave.²⁷ Nuk është caktuar ende seancë për konfirmim në këtë rast, pavarësisht nga fakti se ligji kërkon nga gjykatat që të caktojnë seancën për konfirmim të aktakuzës, menjëherë dhe jo më vonë se dy muaj nga data kur është ngritur aktakuza.²⁸ I pandehuri fillimisht u mbajt në paraburgim nga data 12 mars 2008 deri me 26 maj 2008.

OSBE-ja gjithashtu ka monitoruar një numër të rasteve civile, duke përfshirë rastet pronësore ndëretnike, kur funksionimi i gjykatave në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica u ndërpre në shkurt 2008. Edhe në atë kohë veçse ka pasur vonesa të konsiderueshme në procedimin e këtyre rasteve (disa prej tyre datojnë që nga viti 2001), për shkak të arsyeve të ndryshme. Sipas informatave në dispozicion të OSBE-së, këto raste mbeten të bllokuara dhe po presin që gjykatat në veri të Kosovës të ri-fillojnë funksionimin.

Në një padi pronësore ndëretnike, të datës 17 maj 2003, paditësit shqiptarë të Kosovës kishin kërkuar vërtetimin e pronësisë së tyre në lidhje me një

²¹ Shih nenin 3. Veprimi i Përbashkët i Këshillit të Evropës 2008/124/ CFSP i datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVË. Pjesërisht, EULEX-i është i mandatuar që të “mësoj, monitorojë dhe të këshillojë institucionet e Kosovës në të gjitha sferat që ndërlidhen me sundim më të përhapur të ligjit (përfshirë edhe shërbimin e doganave) përdorur mban edhe disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive.” Këto përgjegjësi përfshijnë, *inter alia*, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e disa rasteve.

²² Neni 147 KPPK.

²³ Neni 328(2) KPPK.

²⁴ Neni 343 KPPK.

²⁵ Neni 339 KPPK.

²⁶ Neni 261 KPPK.

²⁷ Neni 164 KPPK.

²⁸ Nenet 309(1) dhe 312(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003 (KPPPK).

pronë të vendosur në Mitrovicë/Mitrovica pranë gjykatës komunale në Mitrovicë/Mitrovica. Gjykata aprovoi padinë e paditësit si të bazuar, përmes një aktvendimi të shpallur me 20 janar 2004, pasi që caktoi një përfaqësues ligjor të përkohshëm për ta dhe pa u përpjekur për të gjetur vendndodhjen e të paditurve. Të paditurit, serb të Kosovës të zhvendosur brenda vendit, të cilët gjatë tërë kohës kishin jetuar dhe punuar në Mitrovicë/Mitrovica dhe Zvečan/Zveçan, më pas, me 4 prill 2005 parashtruan një kërkesë për rigjykim, pasi që kishin mësuar për humbjen e pasurisë së tyre. Vetëm me 6 nëntor 2007, më shumë se dy vjet e gjysmë më vonë, gjykata mbajti seancë në përgjigje të propozimit të të paditurve për rigjykim, kur vendosi që të lejohet përsëritjen e procedurës. Në ndërkohë, megjithatë, prona dyshohet se tashmë i ishte shitur një pale të tretë. Pas nëntorit 2007 gjyqtari komunal i rastit nuk caktoi ndonjë seancë të radhës dhe procedura u pezullua në shkurt 2008, dhe mbetet e bllokuar deri në këtë ditë.

E drejta për liri

Praktika gjyqësore e GjEDNj, si dhe korniza ligjore e Kosovës parashohin se çdo periudhë e paraburgimit duhet të rishikohet periodikisht nga një gjykatë.²⁹ Në rast të paraburgimit të zgjatur, agjencitë e zbatimit të ligjit kanë për detyrë të tregojnë se arsyet për paraburgim vazhdojnë të ekzistojnë, dhe të zhvillojnë procedurat me përkushtim të veçantë.³⁰ Për më tepër, paraburgimi nuk duhet të zgjasë më shumë se që është e nevojshme,³¹ përndryshe bëhet i paligjshëm, dhe personi duhet të lirohet në pritje të gjykimit.³²

Mungesa e një sistemi gjyqësor dhe prokurorial plotësisht funksional në komunat veriore, çon në shkelje serioze të së drejtës për liri. Në fillim të nëntorit 2009, lista e të paraburgosurve pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, tregonte 32 persona që mbahen në paraburgim dhe 19 persona në arrest shtëpiak. Një listë e ngjashme nga gjykata komunale e Mitrovicë/Mitrovica, tregonte pesë persona në paraburgim dhe dy persona në arrest shtëpiak. Urdhrat për paraburgim kundër shumë prej këtyre të pandehurve u shtyn vazhdimisht gjatë periudhës që kur gjykatat funksionojnë vetëm me kapacitet të kufizuar.

Në një rast para gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një i pandehur i akuzuar për vrasje të rëndë,³³ vrasje në tentativë,³⁴ dhe pronësi, kontroll, posedim, apo përdorimi të paautorizuar të armëve,³⁵ ishte mbajtur në paraburgim që nga data 6 shkurt 2007. Gjykimi kundër tij ishte në fazën përfundimtare kur gjykata ndaloi funksionimin, por që nga ajo kohë nuk është

²⁹ Nenet 212(4) dhe 284-287 KPPPK.

³⁰ Neni 285 (1) KPPPK; shih gjithashtu, *Dobrev kundër Bullgarisë*, GjEDNj, aktgjykim i 10 gushtit 2006, paragrafi 79.

³¹ Neni 5(3) KPPPK; shih gjithashtu, *Labita kundër Italisë*, GjEDNj, aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 152.

³² Shih nenet 5(1)(c) dhe 5(3), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³³ Neni 147(1), 23 KPPK.

³⁴ Nenet 146(1), 20 dhe 23 KPPK.

³⁵ Id. Neni 328(2) KPPK.

bërë ndonjë progres. Gjykata shtyu vazhdimisht paraburgimin e tij, deri me 3 mars 2010.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një i pandehur i akuzuar për vrasje³⁶ dhe pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve³⁷ ishte mbajtur në paraburgim që nga 31 maji 2007. Gjykimi i tij nuk kishte filluar ende në kohën kur gjykata ndaloi funksionimin. Paraburgimi i tij ishte shtyrë vazhdimisht, deri me 5 mars 2010.

Shumë persona tjerë të paraburgosur, në bazë të urdhrave të lëshuara nga gjykata e qarkut dhe ajo komunale në Mitrovicë/Mitrovica, ndodhen në situatë të ngjashme. Kjo gjendje ngrit shqetësime serioze sa i përket respektimit të së drejtës së tyre fundamentale për liri.

Kushtet e vështira të punës për gjyqtarët dhe prokurorët aktualisht të rivendosur përkohësisht

Një raport mbi sistemin e drejtësisë lidhur me rajonin e Mitrovicë/Mitrovica nuk do të ishte i plotë pa një përshkrim të shkurtër të kushteve shumë të vështira të punës në të cilat veprojnë gjyqtarët, prokurorët dhe personeli ndihmës nga gjykatat dhe prokuroritë aktualisht të rivendosura.

Siç u përmend më herët në këtë raport, në hapësirat e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn përveç stafit të saj, aktualisht është i vendosur edhe personeli i gjykatës së qarkut, komunale dhe për kundërvajtje nga Mitrovicë/Mitrovica dhe ai i prokurorisë publike të qarkut dhe prokurorisë publike komunale. Lokalet e gjykatës komunale të Vushtrri/Vučitrn janë kështu rëndë të mbingarkuara dhe të gjithë zyrtarët që punojnë aktualisht në këtë gjykatë, si dhe të gjitha palët që vijnë para tyre, duhet të veprojnë në një mjedis shumë të dyndur.

Andaj, gjykata e qarkut e Mitrovicë/Mitrovica shfrytëzon gjykatoren e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn. Një numër i përgjithshëm i 10 deri 15 gjyqtarë dhe personel ndihmës janë të vendosur në atë gjykatore. Gjyqtarët po ashtu shfrytëzojnë një zyrë shtesë kur ka nevojë që të mbajnë seanca dëgjimore për paraburgim apo gjykime civile.

Gjykatës komunale të Mitrovicë/Mitrovica i është dhënë një zyrë e vetme në madhësi prej vetëm afro shtatë metra katror, në hapësirat e gjykatës komunale të Vushtrri/Vučitrn. Në atë zyrë të vetme punojnë kryetari i gjykatës, një apo dy gjyqtarë, pesë punonjës administrativ nga gjykata komunale e Mitrovicë/Mitrovica dhe dy punonjës administrativ nga gjykata komunale e Vushtrri/Vučitrn. Kurdo që është e nevojshme të mbahet ndonjë seancë apo gjykim, gjyqtarët e Mitrovicë/Mitrovica duhet t'i kërkojnë ndonjërit prej kolegëve të tyre të Vushtrri/Vučitrn leje për të shfrytëzuar zyrën e tyre.

³⁶ Neni 146 KPPK.

³⁷ Neni 382 KPPK.

Gjykata për kundërvajtje e Mitrovicë/Mitrovica shfrytëzon një zyrë prej rreth 12 metra katror në gjykatën komunale të Vushtrri/Vučitrn. Rreth 24 punonjës shfrytëzojnë atë zyrë, me së paku 10 persona të pranishëm çdo ditë.

Prokuroria publike e qarkut e Mitrovicë/Mitrovica shfrytëzon një zyrë prej 16 metra katror në ndërtesën e gjykatës komunale të Vushtrri/Vučitrn . Një numër i përgjithshëm prej nëntë vetë janë të vendosur në këtë zyrë: pesë prokurorë, një administrator, dy regjistruer, dhe një përkthyes kurdo që është e nevojshme. Në mënyrë të ngjashme, prokuroria publike komunale e Mitrovicë/Mitrovica përdor një zyrë prej rreth 12 metra katror në gjykatën komunale në Vushtrri/Vučitrn. Të paktën 17 pjesëtarë të stafit përdorin këtë zyrë, me të paktën dhjetë prej tyre të pranishëm aty çdo ditë. Kur një prokuror komunal ose i qarkut duhet të merr në pyetje ndonjë palë pjesëtarët e tjerë të stafit duhet të largohen nga zyra, por në disa raste marrja në pyetje është bërë në prani të tjerëve.

Kushte të tilla pune bien shumë prapa standardeve të themeluara ndërkombëtare,³⁸ dhe dëmtojnë jo vetëm efikasitetin e gjykatave, por edhe vet dinjitetin që duhet të jetë thelbësor në funksionimin e organeve gjyqësore. Duke u dashur të veprojnë në një mjedis të tillë e bën pothuajse të pamundur për gjykatësit dhe prokurorët që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive, dhe gjithashtu çojnë në një mori problemesh dhe vështirësi të përditshme logjistike. Ajo që është dhënë më-poshtë mund të shërbejë si shembull.

Para tetorit 2008, prokuroria e rivendosur publike komunale e Mitrovicë/Mitrovica pranoi nga policia shkresat e lëndës për rastet urgjente dhe ato të cilat parashohin paraburgim. Të gjitha shkresat e lëndëve për rastet e tjera të prokurorisë janë mbajtur në sirtarët e policisë për shkak të mungesës së hapësirës për ruajtje. Me 30 tetor 2008, kryeprokurori publik komunal i Kosovës i dërgoi një letër kryeprokurorit publik komunal të Mitrovicë/Mitrovica me të cilën e urdhërojë atë që të pranojë të gjitha kallëzimet penale në zyrën e tij. Më pas të gjitha kallëzimet penale drejtuar prokurorisë publike komunale të Mitrovicë/Mitrovica u pranuan. Me 11 gusht 2009, kryeprokurori publik komunal i Mitrovicë/Mitrovica i dërgoi një letër njësisë së policisë rajonale e hetimeve në Mitrovicë/Mitrovica për ti informuar ata se nga data e letrës prokuroria nuk mund të pranojë më kallëzime penale për raste (me përjashtim të rasteve urgjente dhe rasteve ku parashihet paraburgimi) për shkak të mungesës së objekteve adekuate për ruajtje. Me 12 tetor 2009 Kryeprokurori i Kosovës i dërgoi një letër tjetër kryeprokurorit publik komunal të Mitrovicë/Mitrovica, me të cilën e urdhërojë atë që të pranojë dhe regjistroj të gjitha kallëzimet penale të ngritura pranë zyrës së tij dhe të punojë në to sa më shumë që të jetë e mundur, dhe të mos ti kthej policisë asnjë kallëzim penal. Pas kësaj kërkesë, prokuroria publike komunale e Mitrovicë/Mitrovica përsëri fillojë të pranojë në zyrë të gjitha kallëzimet e ngritura penale. Aktualisht, shkresat e lëndëve mbahen në kuti kartoni të vendosura në një zyrë, si dhe në sirtarë të hapur.

³⁸ Shih Parimin V (2), Rekomandimi Nr. R (94) 12, të Këshillit të Evropës nga Shtetet Palë mbi Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve. (E adoptuar nga Këshilli i Ministrave, me 13 tetor 1994 në takimin e 518-të të zëvendës ministrave).

Kjo metodë e ruajtjes natyrisht që rrit rrezikun e humbjes apo ngatërrimit të lëndëve.

Përfundim

Ka pasur vetëm disa zhvillime pozitive në funksionimin e sistemit të drejtësisë në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica gjatë tërë vitit 2009. Një pjesë e madhe e gjyqësorit në rajon mbetet e paralizuar si më parë.

Gjykatat dhe prokuroritë aktualisht të rivendosura nuk mund të trajtojnë në mënyrë efektive rastet dhe paditë e ngritura pranë tyre, duke i lënë banorët e rajonit të Mitrovicë/Mitrovica me qasje shumë të kufizuar në drejtësi. Shumica e rasteve penale, civile dhe të kundërvajtjeve që konsiderohen jo-urgjente, nuk janë duke u trajtuar, dhe rrezikohet që periudha e paraparë për parashkrim ligjor të tyre të skadojë. Kur rastet nuk procedohen, ato pasohen nga vonesa të paarsyeshme dhe pezullime të pafundme. Shumë të pandehurve të mbajtur në paraburgim vazhdimisht u shtyhet paraburgimi dhe gjykatat e prokuroritë e rivendosura qartazi nuk janë në gjendje të trajtojnë me kujdes të veçantë rastet e paraburgimit, që kërkohet prej tyre me ligj vendor dhe ndërkombëtar. Vendosja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it ishte një zhvillim pozitiv, por me vetëm pesë raste penale të kryera në Mitrovicë/Mitrovica, gjatë dhjetë muajve të parë të veprimit të tyre, dhe bazuar në nivelet aktuale të kuadrit dhe juridiksionit të tyre të kufizuar, fatkeqësisht edhe ndikimi i tyre është vetëm i kufizuar.

Në drejtim të tërë asaj që u tha më lartë, OSBE edhe njëherë nënvizon se mungesa e një sistemi gjyqësor plotësisht funksional në veri të Kosovës paraqet pengesa të mëdha në të drejtat e individit për qasje në drejtësi, gjykim brenda kohës së arsyeshme dhe në liri. Mungesa e një sistemi gjyqësor funksional në komunat veriore për tashmë afër dy vjet, në masë të madhe ka zbehur besimin e publikut në institucionet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore, dhe në sundimin e ligjit në përgjithësi. Për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit dhe për t'i vënë fund shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, OSBE fton të gjithë akterët e përfshirë që të rritin përpjekjet e tyre për të rikthyer një sistem gjyqësor funksional në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica.